



# CRÉDIT AGRICOLE S.A.

Montrouge, 6 Maj 2015

Tremujori i parë 2015

## Rezultate të mira nxitur nga veprimtaria aktive dhe kushte të favorshme të tregut

- Veprimtaria në të gjitha linjat e biznesit
- Kostot kontrolluar mbi bazë rregullatore
- Ulje e mëtejshme në koston e riskut
- Strukturë e fuqishme financiare e konfirmuar

### Grupi\* Crédit Agricole në tremujorin e parë të 2015

Të ardhura: 8,035 milion euro (+3.1% / T1-14)

Të ardhura para tatimit: 2,131 milion euro (+8.0% / T1-14)

Pjesa e të ardhurave neto të Grupit: 1,228 milion euro (-1.9% / T1-14)  
përfshirë -€222m për SRF dhe -€194m për ndikimin e IFRIC 21

Raporti CET 1 plotësisht i ngarkuar: 13.0% (+130 bp / T1-14)

\* Crédit Agricole SH.A. dhe Bankat Rajonale në 100%

### Crédit Agricole SH.A. në tremujorin e parë të 2015

Të ardhura: 4,359 milion eurs (+7.5% / T1-14)

Të ardhura operative bruto: 1,206 milion euro (+4.4% / T1-14)

Kosto e Riskut: -477 milion euro (-19.2% / T1-14)

Pjesa e të ardhurave neto të Grupit: 784 milion euro (+2.6% / T1-14)  
përfshirë -€182m për SRF dhe -€130m për ndikimin e IFRIC 21

Raporti CET 1 plotësisht i ngarkuar: 10.2% (+120 bp / T1-14)

## Grupi Crédit Agricole

Grupi Crédit Agricole pati pjesë të të ardhurave neto të Grupit prej 1,228 milion euro në tremujorin e parë të 2015, një ulje prej 1.9% krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2014. Ky krahasim duhet marrë në konsideratë faktin se atë vit, shifrat përfshijnë kontributin e parë në Fondin e Zgjidhjes së Vetme (SRF) në shumën e -222 milion euro në pjesën e të ardhurave neto të Grupit.

Pa përfshirë këtë zë dhe para aplikimit të interpretimit të IFRIC 21, i cili solli të dhëna të krahasueshme të riparaqitura në vitin 2014, pjesa e të ardhurave neto të Grupit Crédit Agricole do ishin në 1,644 milion euro, një rritje prej 15.8% krahasuar me shumën e paraqitura prej 1,420 milion euro për tremujorin e parë të vitit 2014.

Për Jean-Marie Sander, Kryetar i Crédit Agricole SH.A., këto rezultate konfirmojnë gjendjen e mirë të Crédit Agricole dhe janë në linjë me objektivat e saj të përfitimit afatmesëm.

Për Jean-Paul Chifflet, Drejtor Ekzekutiv i Crédit Agricole SH.A., këto rezultate të mira erdhën si pasojë e një momenti të mirë të biznesit në të gjitha linjat e biznesit. Ata konfirmojnë tendencën e vitit 2014, me një ulje të vazhdueshme, të veçantë në koston e riskut në shumicën prej linjave të biznesit, kontrollin e kostos efikase dhe konfirmimin e fuqisë së strukturës financiale të Grupit.

Bankat Rajonale patën një performancë tregtare të qëndrueshme klimës së ngadaltë ekonomike dhe normës së pafavorshme të interesit. Totali i aseteve të klientit shkoi në 3.2% krahasuar me fundin e Marsit të vitit 2014 dhe kreditë e papaguara shkuan deri në 1.0% gjatë të njëjtës periudhë. Kontributi i tyre në pjesën e të ardhurave neto të Grupit (në 100% sipas IFRS) arriti në 790 milion euro tremujorin e parë të vitit 2015. Diferenca krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2014 është si shkak i kontributit të tyre në SRF në shumën e 52 milion euro.

Në kushtet e aftësisë paguese, Grupi Crédit Agricole, Basel 3 ngarkuar plotësisht në Kapitalin e Përbashkët Tier 1 raporti ishte 13.0% në fund të Marsit 2015 krahasuar me 11.7% raportuar në fund të Marsit 2014.

## Crédit Agricole SH.A.

Bordi Drejtues i Crédit Agricole SH.A., me në krye Jean-Marie Sander, u mbledh më 5 Maj 2015 për të ekzaminuar pasqyrat financiare për tremujorin e parë të vitit 2015.

Pjesa e të ardhurave neto të Grupit ishte 784 milion euro, një rritje vit pas viti prej 2.6% krahasuar me pjesën e Grupit për tremujorin e parë të paraqitur të vitit 2014. Për informacione, bazuar në rregulloret në fuqi deri në 2014, psh. Para aplikimit të IFRIC 21 dhe duke përjashtuar ndikimin e kontributit të SRF, pjesa e të ardhurave neto të Grupit do të ishte 1,096 milion euro, një rritje prej 26,3% krahasuar me shifrat e paraqitura prej 868 milion euro për tremujorin e parë të vitit 2014.

Kjo performancë e mirë u nxit kryesisht nga veprimtaria aktive e biznesit, me të ardhura deri në 7.5% vit pas viti. Të gjitha linjat e biznesit kontribuan: kreditë e papaguara deri në 2.9% në LCL, kreditë e papaguara për shtëpi deri në 4.9% te Cariparma, flukset hyrëse prej 24 miliard euro për Amundi, prej 2.3 miliard euro në kursime/pensione dhe në rast vdekje & paaftësie, dhe 1.5 miliard euro për Bankingun Privat, asete nën kujdestari dhe administrimin te CACEIS më shumë se 10%, financat e reja të klientit u rritën me pothuajse 10%, dhe rritja e të ardhurave me pothuajse 30%<sup>1</sup> në tregun e kapitalit dhe bankingut të investimit.

Kjo performancë u mbështet gjithashtu nga një ulje e vazhdueshme e koston së riskut, e cila u ul në 46 pikë bazë të mospagesave në baza vjetore, psh një përmirësim prej 14 pikë bazë krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2014. Kosto e riskut u ul në shumicën prej linjave të biznesit: LCL (20 pikë bazë kundrejt 30 në tremujorin e parë të vitit

<sup>1</sup> Riparaqitur për ndikimin e funksionimit të DVA dhe në norma konstante shkëmbimi

2014), bankingu ndërkombëtar me pakicë (135 pikë bazë kundrejt 141) dhe financat e klientit (212 pikë bazë kundrejt 293), kryesisht për shkak të vazhdimësisë së rënies të Agos Ducato (në shumën prej – 104 milion euro duke u ulur me 36% krahasuar me T1-2014).

Për më tepër, kostot operative mbaheshin në një mjedis të mirë biznesi dhe në një ndikim negative të ndryshimeve rregullatore. Kontributi i parë në Fondin e Zgjidhjes së Vetme (SRF) llogariten në 6% të rritjes në shpenzimet operative. Duke përjashtuar valutën, rregullimet dhe investimet ose efektet e planit të transformimit, shpenzimet operative ishin deri në 1.2% krahasuar me tremujorin e parë të 2014.

Në fund të muajit Mars 2015, struktura e kapitalit të Crédit Agricole SH.A. ishte e konsoliduar, me një raport të ngarkuar plotësisht të Kapitalit të Përbashkët Tier 1 prej 10.2%, një përmirësim prej 120 pikë bazë në 9.0% regjistruar në fund të Marsit 2014. Pas një rritje të menjëhershme gjatë 2014, raporti ka rënë lehtë në fund të Marsit 2015 (me 20 pikë bazë) që nga fund i Dhjetorit 2014. Vlerësimi i dollarit amerikan ishte shkak i rritjes me një të tretat të aseteve me risk, i barazvlefshëm me 16 pikë bazë zbritur në raport, 8 pikë bazë të tjera lidhen me ndikimin sezonal të IFRIC 21 (përfshirë SRF). Në të kundërt rritja e asteve me risk ishte në përputhje me prirjet e mëdha në të ardhura.

Pozicioni i likuiditetit të Grupit Crédit Agricole është fuqizuar më tej. Në fund të muajit Mars 2015, bilanci në cash i Grupit arriti në shumën 1,042 miliard euro dhe teprica afatgjatë e burimeve financuese gjatë zbatimit afatgjatë të fondeve ishte 104 miliard euro kundrejt 73 miliard euro në fund të muajit Mars 2014. Rezervat e likuiditetit, duke përfshirë fitimet capital dhe shkurtimeve lidhur me portofolin e letrave me vlerë, ishin në shumën e 248 miliard euro dhe mbuluan borxhin afatshkurtër bruto më shumë se dy herë, në 217% krahasuar me 164% në fund të Marsit 2014.

Të dyja, Grupi dhe Crédit Agricole SH.A. kishin një raport LCR më të madh se 110% në fund të Marsit 2015.

Në fund të Marsit 2015, Crédit Agricole SH.A. kishte plotësuar 54% të programit të tij prej 10 miliard euro të borxhit afatmesëm në afatgjatë (në vjetërsi dhe vartësi) lëshimin në treg (duke përjashtuar rjetet e degëve). U rrit me 1.8 miliard barazvlefshme në euro të borxhit të vjetër dhe bëri lëshimin e Tier 2 përbërë nga këste 12-vjetore prej 2 miliard euro dhe një këst prej 10-vjetore prej 1.5 miliard dollarë amerikan.

Mbi të gjitha, lëshuesit kryesorë të Grupit Crédit Agricole u rritën me 10.7 miliard euro të borxhit të vjetër dhe atij me vartësi në treg dhe rjetet e degëve në tremujorin e parë të vitit 2015.

## **Përgjegjësia Sociale dhe Mjedisore**

Si ofruesi kryesor i financave në ekonominë Franceze, Crédit Agricole rikonfirmon angazhimin e saj për të ndihmuar krijimin e një ekonomie që prodhon më pak gaze serë. Që prej vitit 2010, Crédit Agricole është kthyer në ofruesin kryesor të financave për projektet mbi energjinë e rinovueshme në Francë. Leasing & Factoring i Crédit Agricole dhe filiali i saj Unifergie, i cili është i angazhuar fuqishëm në këtë fushë, kishte financuar 2.3 miliard euro për projekte në fund të 2014. Crédit Agricole CIB është numri 1 në botë për Bonot e Gjelbra, me 14% aksione në treg. Në shtator 2014, Amundi paraqiti vargun e saj të gjurmuesit të indeksit të ulët të karbonit për investitorët, një inovacion i ri global. Mbi të gjitha, janë investuar në këto fonde 2.5 miliard euro. Për më tepër, po krijohet një kompani e përbashkët për menaxhimin e portofolit me EDF për të financuar energjinë e rinovueshme dhe efikasitetin e energjisë nëpërmjet investitorëve institucionalë dhe ato me pakicë. Objektivi është ngritja e 1.5 miliard euro. Amundi, menaxheri kryesor SRI i aseteve në Francë me 71 miliard euro asete nën menaxhimin në fund të Dhjetorit 2014, ka krijuar gjithashtu një fond mjedisor tematik– Amundi Valeurs Durables – i cili pati 121 milion euro. Si investitor institucional, Sigurimet Crédit Agricole, me mbështetjen e Amundi dhe Crédit Agricole Immobilier, fokusohet në asetet investuese të cilat janë çelësi i transmetimit të energjisë, si psh format e reja të energjisë dhe ndërtimet efikase të energjisë.

## Kalendari Financiar

20 Maj 2015	Mbledhja vjetore e Aksionerëve në Lille
28 Maj 2015	Marrja e Vendimit të Shpërndarjes së Dividentit
23 Qershor 2015	Pagesa e Dividentit
4 Gusht 2015	Publikimi i rezultateve të tremujorit të dytë të 2015
6 Nëntor 2015	Publikimi i rezultateve të tremujorit të tretë të 2015

*Në të gjithë dokumentin përjashtuar elementët e aftësisë paguese, të dhënat e 2014 janë riparaqitur nga ndryshimet metodologjike në kontabilitet pas aplikimit të interpretimit të IFRIC 21*

### Heqje dorë nga përgjegjësia

Ky prezantim mund të përfshijë një informacion me perspektivë për Grupin, caktuar si informacion mbi tendencat. Kjo e dhënë nuk përfaqëson parashikimet brenda kuptimit të Rregullores 809/2004 të Bashkimit Europian të datës 29 Prill 2004 (kapitulli 1, neni 2/10). Ky informacion u përpilua nga skenare të bazuar në një numër supozimesh ekonomike për një konkurrencë të caktuar dhe mjedis rregullator. Për këtë arsye, këto supozime janë nga natyra faktorë të rastësishëm të cilët mund të shkaktojnë rezultate aktuale për të ndryshuar nga projeksionet.

Gjithashtu, pasqyrat financiare bazohen në vlerësime, veçanërisht në llogaritjen e vlerës së tregut dhe vlerësimin e aktiveve. Lexuesit duhet të marrin në konsideratë të gjithë këto faktorë risku dhe pasigurie para se të japin gjykimin e tyre.

### Standartet e aplikueshme dhe krahasueshmëria

Shifrat e paraqitura për periudhën tremujore që përfundon më 31 Mars 2015 janë hartuar në përputhje me IFRS përshtatur me Bashkimin Europian dhe e aplikueshme në atë datë. Ky informacion financiar nuk përbën një sërë pasqyrash financiare për periudhën e përkohshme të caktuar nga IAS 34 "Raportimi i Përkohshëm Financiar" dhe nuk është audituar.

## REZULTATET E KONSOLIDUARA TË CREDIT AGRICOLE SH.A.

(në milion euro)	T1-15	T1-14 Riparaqitur lfric 21	Ndryshimi T1/T1	Ndryshimi T1*/T1*
Të ardhurat	4,359	4,055	+7.5%	+9.4%
Shpenzimet operative para SRF	(2,978)	(2,901)	+2.7%	+2.7%
SRF	(175)			
<b>Fitimi operativ bruto</b>	<b>1,206</b>	<b>1,154</b>	<b>+4.4%</b>	<b>+26.9%</b>
Kosto e Riskut	(477)	(590)	(19.2%)	(19.2%)
<b>Fitimi operativ</b>	<b>729</b>	<b>564</b>	<b>(29.1%)</b>	<b>+79.5%</b>
Përqindja e fitimit neto nga subjekte të kapitalit	476	455	+4.6%	+7.7%
Fitimi neto nga aktive të tjera	(2)	5	nm	nm
Ndryshimi në vlerën e emrit të mirë	-	-	nm	nm
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>1,203</b>	<b>1,024</b>	<b>+17.3%</b>	<b>+45.0%</b>
Tatimi	(288)	(164)	+74.6%	x2.0
Të ardhurat neto jo të vazhdueshme	(17)	(1)	nm	nm
<b>Fitimi neto</b>	<b>898</b>	<b>859</b>	<b>+4.5%</b>	<b>+32.7%</b>
Interesat jo kontrolluese	114	95	+19.6%	+51.3%
<b>Pjesa e të ardhurave neto të Grupit</b>	<b>784</b>	<b>764</b>	<b>+2.6%</b>	<b>+30.9%</b>

\* Riparaqitur për zëra specifik në tremujor (shiko slide-in 34)

Në tremujorin e parë të 2015, **të ardhurat** arritën në 4,359 milion euro dhe në 4,384 milion euro riparaqitur në vlerësimin e borxhit të vet, funksionimi i DVA dhe mbrojtjen e kredisë. Në tremujorin e parë të 2014, të ardhurat ishin 4,055 milion euro dhe 4,008 milion euro riparaqitur për vlerësimin e borxhit të tij, DVA, mbrojtja e kredisë dhe vlerësimi i bonove të Bankës së Italisë. Të ardhurat e riparaqitura pësuan një rritje vit pas viti me 9.4%.

**Shpenzimet operative** ishin 3,153 milion euro, duke përfshirë 175 milion euro për kontributin e parë në Fondin e Zgjidhjes së Vetme, 49 milion euro në efektet e valutës dhe 26 milion euro për shkak të taksave të reja, kompensuar nga një ulje në tatimin sistematik (33 milion euro) dhe ndikimi pozitiv i efekteve të qëllimit dhe planin<sup>1</sup> e transferimit të LCL (-1 milion euro). Riparaqitur nga këto zëra, shpenzimet operative u rritën me 1.2% vit pas viti në tremujorin e parë të 2015.

<sup>1</sup> Përfshirë BFCAG

**Kosto e Riskut** ishte 477 milion euro, nën 19.2% krahasuar me tremujorin e parë 2014, duke reflektuar një përmirësim të vazhdueshëm në bankingun francez me pakicë dhe duke u kthyer në nivele normale të Agos Ducato, filiali financiar i klientit Italian, ku kosto e riskut u ul 36% vit pas viti, në 104 milion. Për këtë arsye, kosto e riskut arriti në 46 pikë bazë të papagimeve në baza vjetore, një përmirësim me 14 pikë bazë gjatë tremujorit të parë të 2014.

Kreditë me problem të papaguara ishin 15.3 miliard euro, që përbëjnë 3.6% të kredive të papaguara<sup>1</sup> bruto të klientit dhe interbank, krahasuar me 3.8% në fund të muajit Mars 2014. Raporti i kredive me problem mbuluar nga rezerva të veçanta ishte 54.6%. Duke përfshirë rezervat kolektive, raporti i mbulimit të kredive me problem ishte 72.8% krahasuar me 71.1% në fund të muajit Mars 2014.

**Përqindja e fitimit neto nga subjekte të tjera** arriti në 476 milion euro në tremujorin e parë të 2015, duke përfshirë 363 milion euro kontribut nga Bankat Rajonale, 64 milion euro nga Crédit Agricole CIB, kryesisht nga Banque Saudi Fransi, dhe 43 milion euro në shërbimet financiare të specializuara, kryesisht lidhur me partnershipet e financimit të automjeteve.

Mbi të gjitha, **pjesa e të ardhurave neto të Grupit** të Crédit Agricole SH.A. arriti në 784 milion euro në tremujorin e parë të 2015. Riparaqitur për vlerësimin e borxhit të tij, funksionimin e DVA, mbarojtjen e kredisë dhe ndikimin në Fondin e Zgjidhjes së Vetme, pjesa e të ardhurave neto të Grupit ishte 981 milion euro kundrejt 749 milion euro në tremujorin e parë të 2014, riparaqitur për të njëjtat zëra dhe për vlerësimin e bonove të Bankës së Italisë. Kjo paraqet një rritje vit pas viti prej 30.9%.

## **AFTËSIA PAGUESE**

Në fund të muajit Mars 2015, fuqia financiare e Crédit Agricole SH.A. u konfirmua nga niveli i ngarkuar plotësisht i CET1 që arriti në 10.2%<sup>2</sup>, deri në 120 pikë bazë gjatë një viti dhe nën 20 pikë bazë në tremujorin e parë të 2015. Pavarësisht fitimeve të mbartura (duke përjashtuar IFRIC 21) që përmirësuan raportin me 23 pikë bazë dhe rritjen e fitimeve të përealizuara në AFS në qëllimin e sigurimit që kontribuoi në 9 pikë bazë (ndikimi neto i REA), disa elemente të pafavorshme që ndikojnë në raport. Ndikimi sezonal i implementimit IFRIC 21 arritën në shumën e -8 pikë bazë (duke përfshirë kontributin e parë në Fondin e Zgjidhjes së Vetme (SRF)), ndikimi neto i valutës, kryesisht në USD, pati ndikim në -16 pikë bazë, ndërkohë që rritja organike e linjave të biznesit rriti REAs me 9.3 miliard euro në normën konstante të këmbimit, një rritje veçanërisht i dukshëm në CACEIS dhe në CIB.

Raporti<sup>2</sup> total i fazave ishte 19.7% në 31 Mars 2015, deri në 350 pikë bazë gjatë një viti dhe 10 pikë bazë në tremujorin e parë. Në veçanti, përfitimet erdhën nga çështjet Tier 2 në tremujorin e parë të 2015.

Raporti i levave të Crédit Agricole SH.A. mbeti në 4.4%<sup>3</sup> krahasuar me 4.2% në fund të 2014 sipas Aktit të Deleguar përshtatur nga Komisioni Europian.

<sup>1</sup> Duke përjashtuar transaksionet e brendshme, interesat e përlogaritur dhe qiratë financiare të Crédit Agricole

<sup>2</sup> Duke përfshirë rezultatet e paaudituar në tremujorin e parë të 2015

<sup>3</sup> Subjekt i autorizimit ECB, me një ndikim prej +100 pikë bazë lidhur me veprimet brenda grupit

## LIKUIDITETI

Bilanci i cash-it të Grupit Crédit Agricole Group ishte 1,042 miliard euro në fund të muajit Mars 2015, krahasuar me 1,029 miliar në fund të muajit Dhjetor 2014 dhe 1,028 miliard euro në fund të muajit Mars 2014.

Teprica e burimeve financuese afatgjata gjatë aplikimit të fondeve afatgjata ishte 104 miliard euro më 31 Mars 2015, kundrejt 101 miliard euro më 31 Dhjetor 2014 dhe 73 miliard euro më 31 Mars 2014, një rritje prej 3 miliard euro që nga 31 Mars 2014 dhe nga 31 miliard euro ndërmjet 31 Mars 2014 dhe 31 Mars 2015.

Rezervat e likuiditetit duke përfshirë fitimet e vlerësimit dhe shkurtimet lidhur me portofolin e letrave me vlerë arritën në 248 miliard euro më 31 Mars 2015, duke mbuluar 217.5% të borxhit bruto afatshkurtër kundrejt 203.3% më 31 Dhjetor 2014 dhe 164.2% më 31 Mars 2014. Letrat me vlerë të HQLA pas fitimeve të vlerësimit dhe shkurtimet paraqiten në 162.5% të borxhit afatshkurtër të padepozituara me Bankat Qëndrore. Të dyja, Grupi dhe Crédit Agricole SH.A. kishin një raport që tejkalon LCR me 110% në fund të muajit Mars 2015.

Gjatë tremujorit të parë të 2015, lëshuesit kryesorë të Grupit Crédit Agricole u rritën me 10.7 miliard euro të borxhit të vjetër dhe atij në varësi në treg dhe rrjetet e degës. Vetë Crédit Agricole SH.A. rriti 1.8 miliard euro të borxhit të vjetër dhe plotësoi Tier 2 përbërë nga një këst 12-vjetor prej 2 miliard euro dhe një këst 10-vjetor 1.5 miliard dollar amerikan. Në fund të 31 Marsit 2015, Crédit Agricole SH.A. kishte plotësuar 54% të programit të tij financues afatgjatë të tregut (të vjetër dhe në vartësi) prej 10 miliard euro (duke përjashtuar rrjetet e degës).

## REZULTATET SIPAS LINJËS SË BIZNESIT

### 1. TREGU BANKAR FRANCEZ ME PAKICË

#### 1.1. BANKAT RAJONALE TË CREDIT AGRICOLE

<i>(në milion euro)</i>	T1-15	T1-14	Ndryshimi T1/T1
<b>Të ardhurat neto të llogaritura sipas metodës së kapitalit neto (në ~ 25%)</b>	<b>198</b>	<b>208</b>	<b>(4.8%)</b>
Ndryshim i pjesës së të ardhurave neto të Bankave Rajonale	165	149	+10.6%
<b>Pjesa e Fitimit Neto te enteve me kapital të kontabilizuar</b>	<b>363</b>	<b>357</b>	<b>+1.7%</b>

Në tremujorin e parë të vitit 2015, Bankat Rajonale vazhduan të zbatonin strategjitë e tyre për rritjen e balancuar në të gjitha fushat e biznesit.

Asetet e klientit vazhduan të rriten, me një rritje vit pas viti prej 3.2% në papagesat e 610 miliard euro në fund të muajit Mars 2015. Rritja u nxit nga të dyja depozitat në bilanc, deri në 3.0% vit pas viti prej 356 miliard euro në fund të muajit Mars 2015, dhe asetet e klientit jashtë bilanci, deri në 3.3% prej 254 miliard. Rritja e depozitave në bilanc erdhi kryesisht nga depozitat me afat (deri në 8.9%), të cilat përfituan nga depozitat me afat maturimi dhe llogaritë (nën 6.2%). Plani i kursimeve të blerjeve të shtëpive pati rritje të lartë në tremujorin e parë (deri në 7.8% vit pas viti), për shkak se klientët kërkonin të përfitonin nga norma e interesit të rregulluar, në Janar para se të ulej më 1 Shkurt. Gjatë të njëjtës periudhë, depozitat e mbajtura në llogaritë e përbashkëta të aksionerëve u rritën me 51.5% vit pas viti. Ndërkohë, asetet e klientëve jashtë bilancit vazhduan të ndikoheshin nga sigurimi i jetës, me rritje vit pas viti me 4.5% në fund të muajit Mars 2015.

Kreditë e papaguara u rritën me 1.0% vit pas viti, në 402 miliard euro në fund të muajit Mars 2015. Rritja erdhi kryesisht nga kreditë për shtëpi (deri në 2.5%) ndërkohë që segmenti i biznesit të SME pati një përmirësim me papagesat deri në 3.4%.

Raporti<sup>1</sup> depozitë-kredi ishte 115% në fund të muajit Maj 2015, ishte i qëndrueshëm krahasuar me fundin e muajit Maj të 2014.

Të ardhurat e Bankave Rajonale (riparaqitur për transaksionet brenda grupit) arritën në 3,472 milion euro në tremujorin e parë të vitit 2015, nga 2.2% në tremujorin e parë të vitit 2014. Kjo shifër përfshin -139 milion euro në rezervat për skemën e kursimeve për blerje shtëpie kundrejt 15 milion në tremujorin e parë të 2014 dhe -189 milion euro në tremujorin e fundit të 2014. Tarifa dhe komisioni i të ardhurave u rrit ndjeshëm me 7.3% vit pas viti, nxitur kryesisht nga një moment i mirë në sigurimin e jetës (tarifat dhe komisionet deri në 14.0% vit pas viti pas rregullimeve vjetore të ndarjes së tarifës) dhe nga shërbimet bankare (deri në 5.1%). Norma e interesit vazhdon të jetë negative ndikuar nga kosto e kursimeve të rregulluara por përfitoi nga një nivel i lartë i penaltiteteve të ripagesave të hershme (deri më 37 milion euro ndërmjet tremujorit të parë të 2014 dhe 2015).

Shpenzimet operative ishin të qëndrueshme (nën 0.2% vit pas viti) duke përjashtuar ndikimin e SRF, të cilat arritën në -46 milion euro në tremujorin e parë të 2015.

Kosto e riskut të Bankave Rajonale vazhdoi të përmirësohej ndjeshëm, duke rënë në 36.4% vit pas viti, në -196 milion euro, barazvlefshëm me uljen prej 11 pikë bazë në kreditë e papaguara. Kjo tendencë reflekton përmirësimin e

<sup>1</sup> Metodologjia e rishikuar nga Marsi 2014; Dhjetor 2013: duke përfshirë EIB dhe financimin CDC dhe obligacionet CAsa të përfshira në kontratatme njësi të lidhura klasifikuar si financime të lidhura konsumatori; dhe kreditë neto të konsumatorit të rezervave specifike



qëndrueshëm në mjedisin ekonomik, e cila rezulton në rënie të detyrimeve të rezervave specifike dhe këmbimit të rezervave kolektive. Raporti i kredive me problem ishte i qëndrueshëm në 2.6%, ndërkohë që raporti i mbulimit, duke përfshirë rezervat kolektive, mbeti mbi 100%.

Fitimi operativ duke përjashtuar ndikimin e SRF arriti në 1,273 milion euro në tremujorin e parë të 2015, nga 3.0% në tremujorin e parë të 2014.

Mbi të gjitha, kontributi i Bankave Rajonale në pjesën e të ardhurave neto të Grupit të Crédit Agricole SH.A. ishte 363 milion euro në tremujorin e parë të 2015 duke patur një rritje vit pas viti prej 1.7%. Për kujtesë, tremujori i parë i çdo viti përfshin ndryshimin në rezervat e aksionit në Bankat Rajonale, i cili arriti në 165 milion euro në tremujorin e parë të 2015 (deri në 10.7% kryesisht për shkak të caktimit dhe mbatjes së mbledhjeve të përgjithshme vjetore të Bankave Lokale.

## 1.2. - LCL

(në milion euro)	T1-15	T1-14	Ndryshimi T1/T1
<b>Të ardhurat</b>	<b>922</b>	<b>956</b>	<b>(3.6%)</b>
Shpenzimet operative para SRF dhe planit të transformimit	(644)	(650)	(0.9%)
SRF	(12)	-	-
Ndikimi i Planit të Transformimit	(8)	(4)	-
<b>Fitimi operativ bruto</b>	<b>258</b>	<b>302</b>	<b>(14.8%)</b>
Kosto e Riskut	(48)	(70)	(31.2%)
<b>Fitimi Operativ</b>	<b>210</b>	<b>232</b>	<b>(9.8%)</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>210</b>	<b>232</b>	<b>(9.9%)</b>
Tatimi	(78)	(84)	(7.3%)
<b>Fitimi neto</b>	<b>132</b>	<b>148</b>	<b>(11.4%)</b>
Interesat jo-kontrolluese	6	7	(11.0%)
<b>Pjesa e të ardhurave neto të Grupit</b>	<b>126</b>	<b>141</b>	<b>(11.4%)</b>

Tremujori i parë i 2015 pati një vazhdimësi të tendencave të vitit 2014, me një kombinim të depozitave më të larta dhe një kosto risku më të ulët.

Nxitur nga një moment i mirë i biznesit, asetet e klientëve u rritën me 3.8% vit pas viti, në tremujorin e parë të vitit 2015, prej 170.8 miliard euro. Depozitat në bilanc u rritën me 3.7%, nxitur kryesisht nga një rritje në depozitat me afat (deri në 10.3%). Asetet e klientit jashtë bilancit u rritën me 3.9% vit pas viti, kryesisht për shkak të momentit nëmirë në sigurimin e jetës (deri në 5.1% gjatë një viti).

Kreditë e papaguara ishin në shumën e 91.9 miliard euro në fund të muajit Mars 2015, një rritje me 2.9% krahasuar me vitin e mëparshëm. Rritja u nxit nga kreditë për shtëpi, të cilat u rritën me 4.8% vit pas viti në shumën e 59.3 miliard euro. Kreditë e SME dhe bizneseve të vegjël u turrën ndjeshëm me 0.8% vit pas viti me shumën e 26.1 miliard euro, ndërkohë që financat e klientit u rritën me 1.1% gjatë të njëjtës periudhë në shumën e 6.6 miliard euro.

Raporti kredi-depozitë ishte 110% në fund të muajit Mars 2015, e qëndrueshme krahasuar me muajin Dhjetor 2014 (109%).

Të ardhurat u ulën me 3.6% vit pas viti në tremujorin e parë të 2015. Norma e interest ishte e ulët krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2014, për shkak të një rënie të normës së depozitave (rreth -40 milion euro vit pas viti në fund të muajit Mars lidhur me normat e rregulluara) dhe në mungesë të fitimeve të portofolit. Në të kundërt, norma e huasë u rrit për shkak të rinegociatave të huave dhe norma lidhur me prodhimin e ri është më i lartë se norma stokut (përfshirë rinegociatat). Komisionet dhe tarifa e të ardhurave u rritën me 4.2%.

Shpenzimet operative, duke përfshirë SRF dhe planin e transformimit, u ulën me 0.9% vit pas viti në tremujorin e parë të 2014. Shpenzimet lidhur me planin e transformimit ishin 8 milion në tremujorin e parë të 2015, dyfishin e shumës së regjistruar në tremujorin e parë të 2014.

Kosto e riskut mbetet e ulët, rënë me 31.2% vit pas viti në tremujorin e parë të 2015. Raporti i kredive me problem ishte 2.3% në fund të Marsit 2015 dhe raporti i mbulimit (duke përfshirë rezervat kolektive) ishte 72.4% krahasuar me 73.8% në fund të muajit Mars 2014.

Mbi të gjitha, pjesa e të ardhurave neto të grupit ishte 126 milion euro, nën 11.4% krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2014.

## 2. BANKINGU NDËRKOMBËTAR ME PAKICË

**Pjesa e të ardhurave neto të Grupit** për linjat e biznesit ishte 27 milion euro në tremujorin e parë të vitit 2015 krahasuar me 7 milion euro në tremujorin e parë të vitit 2014.

(në milion euro)	T1-15	T1-14	Ndryshimi T1/T1
<b>Të ardhurat</b>	<b>644</b>	<b>692</b>	<b>(6.8%)</b>
Shpenzimet operative para SRF	(375)	(385)	(2.4%)
SRF	(8)	-	-
<b>Fitimi operativ bruto</b>	<b>261</b>	<b>307</b>	<b>(15.0%)</b>
Kosto e Riskut	(149)	(258)	(42.6%)
<b>Fitimi Operativ</b>	<b>112</b>	<b>49</b>	<b>x2.3</b>
Përqindja e fitimit neto nga subjekte të kapitalit	1	(12)	nm
Fitimi neto nga active të tjera	-	-	nm
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>113</b>	<b>37</b>	<b>x3.1</b>
Tatimi	(46)	(17)	x2.6
Të ardhurat neto të pavazhdueshme ose nga operacionet e mbajtura për shitje	(16)	-	nm
<b>Fitimi neto</b>	<b>51</b>	<b>20</b>	<b>x2.7</b>
Interesat jo-kontrolluese	24	13	+89.1%
<b>Pjesa e të ardhurave neto të Grupit</b>	<b>27</b>	<b>7</b>	<b>x4.1</b>

**Në Itali**, Cariparma pati një moment të mirë biznesi në tremujorin e parë të 2015. Asetet e klientit ishin në shumën e 95.9 miliard euro në fund të Marsit 2015, një rritje vit pas viti me 8.8%. Kjo rritje erdhi nga përsheptimi në shitjet ndërmjet disa subjekteve italiane të Grupit. Asetet e klientëve jashtë bilancit u rritën me 16.0%, nxitur nga rritja prej 4.7 miliard euro (ose 24%) në sigurimin e jetës dhe në asetet e fondit të përbashkët krahasuar me fundit e muajit Mars 2014. Depozitat në bilanc u ulën me 1.6% të përfitimit nga kursimet e menaxhuara. Kreditë e papaguara ishin në vlerën e 33.3 miliard euro në fund të muajit Mars 2015, një rritje vit pas viti me 0.5% në sajë të performancës së mirë në kreditë për shtëpi, të cilat u rritën me 4.9% vit pas viti.

Për kujtesë, kontributi i Cariparma për Crédit Agricole S.H.A.konsolidoi të ardhurat në tremujorin e parë të 2014 duke përfshirë zërat e njohur në pasqyrat financiare lokale të konsoliduara më 31 Dhjetor 2013. Këto zëra përbëjnë 80 milion euro të zërave periodik pozitiv të njohura në të ardhurat, duke përfshirë 92 milion euro nga rivlerësimi i aksioneve të Bankës së Italisë, dhe -109 milion euro të njohura në koston e riskut (duke përfshirë provizione prej 90 milion euro rezervuar në Qendrën e Korporatës në tremujorin e katërt të 2013 dhe kthyer në tremujorin e parë të 2014).

Riparaqitur për këto zëra, të ardhurat janë rritur me 6.3% vit pas viti në tremujorin e parë të 2015 në vlerën e 418 milion euro. Rritja erdhi nga komisionet dhe tarifa e të ardhurave (deri në 8.6%<sup>1</sup>) për shkak të momentit të mirë në kursimet jashtë bilancit dhe nga një rritje në normën neto të interesit (up 2.3%) në sajë të efektit pozitiv, efekti i çmimit shkoi ngadalë në negative.

<sup>1</sup> Duke përjashtuar zërat e kontabilizuar nga Cariparma në llogaritë lokale të tij 31/12/2013 dhe nga Crédit Agricole S.H.A. në T1-14 (+€80m inë të ardhurat të cilat +€92m për rivlerësimin e bonove të Bankës së Italisë dhe -€109m në koston e riskut) si dhe tatimin mbi të ardhurat idhur me këto zëra

Shpenzimet operative duke përjashtuar Fondin e Zgjidhjes së Vetme (SRF) ulur me 2.8% vit pas viti në tremujorin e parë të vitit 2015. Kontributi i Cariparma për SRF ishte 7 milion euro. Pavarësisht SRF, raporti kosto/të ardhura u përmirësua me 3.3<sup>1</sup> pikë në 55.4% në tremujorin e parë të 2015 për shkak të transformimit të vazhdueshëm të rrejtit.

Kosto e riskut ishte 99 milion euro në tremujorin e parë të 2015, një ulje me 7.7%<sup>1</sup> vit pas viti, nxitur nga përmirësimi në ekonominë italiane dhe menaxhimin e mirë të riskut. Raporti i kredive me problem me ato në total të papaguara ishte 13.3%, me një raport mbulimi 44.6% (përfshirë rezervat kolektive).

Pjesa e të ardhurave neto të Grupit Cariparma ishin në vlerën e 39 milion euro krahasuar me 23 milion euro<sup>1</sup> tremujorin e parë të vitit 2014.

